

RREGULLORE

për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e marrjes së të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurime dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet:

- Dokumentacioni i nevojshëm, mënyra e dorëzimit të tij, si dhe mënyra e vlerësimit të tij në procedurën e dhënies së pëlqimit për marrjen e aksioneve me të drejtë vote në shoqëri të sigurimeve, shuma e përgjithshme nominale grupore e të cilës është e barabartë apo tejkalon 10%, 20%, 33%, 50% apo 75% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të dhëna me të drejtë vote në shoqërinë e sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: pëlqim për marrjen e të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve);
- Dokumentacioni i nevojshëm, mënyra e dorëzimit të tij, si dhe mënyra e vlerësimit të tij në procedurën e dhënies së pëlqimit për marrjen e aksioneve me të drejtë vote në shoqëri brokerimi në sigurime, shuma e përgjithshme nominale grupore e të cilës është e barabartë apo tejkalon 10%, 20%, 33%, 50% apo 75% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të dhëna me të drejtë vote në shoqëri për brokerim në sigurime (në tekstin e mëtejshëm: pëlqim për marrjen e të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri për brokerim në sigurime) dhe
- Dokumentacioni i nevojshëm, mënyra e dorëzimit të tij, si dhe mënyra e vlerësimit të tij në procedurën e dhënies së pëlqimit për marrje të aksioneve me të drejtë vote në shoqëri për përfaqësim në sigurime shuma e përgjithshme nominale grupore e të cilës është e barabartë apo tejkalon 10%, 20%, 33%, 50% apo 75% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të dhëna me të drejtë vote në shoqërinë për përfaqësim në sigurime (në tekstin e mëtejshëm: pëlqim për marrjen e të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri për përfaqësim në sigurime), në pajtim me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

¹ Teksti i konsoliduar i Rregullores është përgatitur në bazë të tekstit të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurim dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2013), Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e marrjes së të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurime dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 35/2017) dhe Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e marrjes së të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurime dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 138/2017), Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e marrjes së të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurime dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.69.2019). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi juridike. Për qëllime juridike, në procesin e dhënies së pëlqimit për marrjen e të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar valide ose fuqiplota janë vetëm tekstet të cilat janë publikuar në Gazetat zyrtare të përmendura më lart.

II. PËLQIM PËR MARRJEN E TË DREJTËS PËR PJESËMARRJE TË KUALIFIKUAR NË SHOQËRI TË SIGURIMEVE

Neni 2

(1) Për marrjen e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, në Agjenci dorëzohet kërkesë për marrjen e pëlqimit për të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet vetëm në formularin e përcaktuar “Kërkesa për marrjen e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve (Formulari K-PPK-SHS)” i cili është dhënë në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

(3) Nëse personi i cili ka për qëllim të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve është person juridik, kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni i bashkangjitet dokumentacioni në vijim:

1. Pyetësor të plotësuar për persona juridikë në formularin përkatës të përcaktuar i cili është dhënë në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
2. Të dhëna për numrin e aksioneve të cilat personi ka për qëllim t’i fitojë në shoqërinë e sigurimeve, të dhëna për numrin e aksioneve të cilat personi ndoshta tashmë i posedon në atë shoqëri të sigurimeve, si dhe të dhëna për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar të shoqërisë para dhe pas përvetësimit ose marrjes së aksioneve;
3. Vendim të organit kompetent të personit juridik për marrjen e aksioneve në shoqërinë e sigurimeve;
- 3.a. Burime të mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë:
 - 3.a.1 Deklaratë të organit kompetent të personit juridik, për prejardhjen e mjeteve me të cilat personi juridik do t’i marrë aksionet në shoqërinë e sigurimeve; dhe
 - 3.a.2 Dëshmi përkatëse për burimin e mjeteve me të cilat personi juridik do t’i marrë aksionet në shoqërinë e sigurimeve, në shumë së paku të barabartë me vlerën nominale të aksioneve të cilat janë lëndë e përvetësimit (raport auditiv i personit juridik, llogari përfundimtare apo dëshmi tjetër përkatëse).
4. Të dhëna dhe dokumente për gjendjen financiare të personit juridik i cili ka për qëllim të marrë pjesë të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve;
5. Vërtetim nga Regjistri Qendror gjegjësisht ndonjë regjistër tjetër publik se ndaj personit juridik nuk ka të shqiptuar sanksion kundërvajtës apo ndalesë dënimi për kryerjen e veprimtarisë në fushën e sigurimit dhe financave;
6. Vërtetim nga Regjistri Qendror gjegjësisht ndonjë regjistër tjetër publik se ndaj personit juridik nuk ka të shqiptuar dënim sekondar dhe atë ndalesë për marrjen e lejes për themelim dhe veprimtari të shoqërisë për sigurim, revokim të lejes për themelim dhe veprimtari të shoqërisë të sigurimeve, ndalesë për themelim të personave të rinj juridikë dhe ndalesë të përkohshme apo e përhershme për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit;
7. Dëshmi se ndaj personit juridik nuk është ngritur proces i falimentimit apo proces i likuidimit dhe atë:
 - 7.1 Vërtetim nga Regjistri Qendror gjegjësisht institucion tjetër kompetent se ndaj personit juridik nuk është ngritur proces falimentimi apo proces likuidimi dhe
 - 7.2 Vërtetim nga organi kompetent i personit juridik se ndaj personit juridik nuk është ngritur proces falimentimi apo proces likuidimi;
8. Dëshmi se personi juridik nuk është i lidhur me ndonjë person tjetër juridik te i cili shoqëria për sigurim (në të cilën personi ka për qëllim të sigurojë pjesëmarrje të kualifikuar) në mënyrë direkte apo indirekte, posedon pronësi prej së paku 10% të kapitalit apo të drejtave të votës te ai person, dhe atë:
 - 8.1 Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se personi juridik nuk është i lidhur me

- ndonjë person tjetër juridik te i cili shoqëria e sigurimeve (në të cilën personi ka për qëllim të sigurojë pjesëmarrje të kualifikuar) në mënyrë direkte apo indirekte, posedon pronësi prej së paku 10 % të kapitalit apo të drejtave të votës te ai person;
- 8.2 Listë e personave të cilët në personin juridik posedojnë, në mënyrë direkte apo indirekte, më shumë se 10% të aksioneve, gjegjësisht pjesëmarrjes, e nënshkruar nga personi zyrtar i personit juridik;
 - 8.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror për letra me vlerë, gjegjësisht regjistër tjetër publik, për atë se kush janë bartësit e aksioneve, gjegjësisht pjesëmarrësit te personi juridik;
 - 8.4 Listë e personave juridikë te të cilët personi juridik në mënyrë direkte apo indirekte posedon më shumë se 10% të aksioneve, gjegjësisht pjesëve, e nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
 - 8.5 Dëshmi nga Regjistri qendror i letrave me vlerë, gjegjësisht ndonjë regjistër tjetër publik për atë se ku personi juridik posedon aksione te persona të tjerë juridikë;
 - 8.6 Dëshmi nga Regjistri qendror i letrave me vlerë, gjegjësisht ndonjë regjistër tjetër publik për atë se ku personi juridik posedon pjesë te persona të tjerë juridikë.
9. Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se personi juridik nuk ka punuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 10. Akt për themelimin gjegjësisht Statutin e personit juridik;
 11. Listë e anëtarëve të organit drejtues në personin juridik (Certifikatë nga Regjistri Qendror apo ndonjë regjistër tjetër publik përkatës);
 12. Certifikatë nga regjistri në të cilën është regjistruar selia e personit juridik;
 13. Kopje nga libri aksionar, gjegjësisht dëshmi nga ndonjë regjistër tjetër publik përkatës për personin juridik;
 14. Raport revizor (Raport për auditim të kryer të raporteve financiare të shoqërisë) i përgatitur nga shoqëria e autorizuar për auditim për dy vitet e fundit të punës për personin juridik. Personat juridikë të cilët janë themeluar dhe veprojnë më pak se dy vite, janë të detyruar të dorëzojnë Raport për auditim të kryer të raporteve financiare të shoqërisë për periudhën për të cilën kanë punuar, me gjendje të datës së paku një muaj para dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes si dhe të dorëzojnë raporte revizore për dy vitet e fundit të punës për aksionarët e tyre – persona juridikë, gjegjësisht të dorëzojnë dokumentacionin përkatës nga paragrafi (5) i këtij neni për aksionarët e tyre – persona fizikë të cilët kanë pjesëmarrje mbi 10% në kapitalin e personit juridik.
 15. Dëshmi për tarifën e paguar për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, në përputhje me Listën tarifore të Agjencisë dhe
 16. Dëshmi të tjera dhe dokumentacion për vlerësim të aftësisë paguese të personit juridik, si dhe vlerësim i aksionarëve të tij, gjegjësisht bartësve të pjesëve.

(4) Nëse **personi juridik** i cili ka për qëllim të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e sigurimit është person juridik i huaj apo person juridik vendas i cili, direkt apo indirekt, është në pronësi të shumicës së personave fizikë apo juridikë të huaj, kërkesës për marrjen e pëlqimit për të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkangjitet edhe dokumentacioni në vijim:

1. dëshmi nga shoqëria e huaj për sigurim se ka leje për kryerje të veprimtarive të sigurimit në vendin amë, nëse aksionari i huaj është shoqëri e sigurimeve;
2. mendim nga institucioni i huaj i autorizuar për mbikëqyrje të shoqërisë së sigurimit, nëse aksionari i huaj është shoqëri e sigurimeve; dhe
3. raport auditiv nga shoqëria e klasës së parë për auditim për vitin e fundit të punës, nëse aksionari i huaj nuk është shoqëri e sigurimeve.

(5) Nëse personi i cili ka për qëllim të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve është person fizik, kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni i bashkangjitet edhe dokumentacioni në vijim:

1. Pyetësor i plotësuar për persona fizikë në formularin e përcaktuar përkatës i cili është dhënë

- në Shtojcën 3 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj. Plotësohen të dhënat (emri dhe mbiemri, vendbanimi dhe adresa dhe numri i letërnjoftimit) për personin fizik të marra nga letërnjoftimi, gjegjësisht dorëzohet kopje nga pasaporta për person fizik të huaj. Bashkangjitur me të dhënat për personin fizik, të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet edhe deklaratë nga personi se ato janë të dhënat e tij dhe janë të sakta, e verifikuar nga ana e personit të autorizuar (noter);
2. Të dhënat për numrin e aksioneve të cilat personi ka për qëllim t'i marrë në shoqërinë për sigurim, të dhënat për numrin e aksioneve të cilat personi ndoshta tashmë i posedon në atë shoqëri të sigurimeve, si dhe të dhënat për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar të shoqërisë para dhe pas përvetësimit të aksioneve;
 3. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë:
 - 3.1 Deklaratë e personit fizik për prejardhjen e mjeteve me të cilat do t'i marrë ose përvetësojë aksionet në shoqërinë e sigurimeve; dhe
 - 3.2 Dëshmi përkatëse për burimin e mjeteve me të cilat personi fizik do të marrë aksione në shoqërinë e sigurimeve me shumë së paku të barabartë me vlerën nominale të aksioneve të cilat janë lëndë e përfitimit (vërtetim për të ardhura të realizuara i dhënë nga organi kompetent tatimor, dokument për shumën e pagës dhe të ardhurave të realizuara në baza të tjera, vendim për trashëgimi, vërtetim nga banka apo institucion tjetër financiar për shumën dhe datën e mjeteve të investuara dhe dëshmi tjetër përkatëse);
 4. Të dhëna dhe dokumente për gjendjen financiare të personit fizik i cili synon të marrë pjesë në shoqërinë e sigurimit;
 5. Dëshmi nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik se kundër personit nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
 6. Vërtetim nga procesverbali penal i gjykatës kompetente se personi nuk është i dënuar me aktgjykim gjyqësor fuqiplotë me dënim me burg pa kusht për më shumë se gjashtë muaj, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike të vendimit, për vepra penale kundër patundshmërisë, vepra penale kundër financave publike, operacioneve të pagesës dhe ekonomisë, vepra penale ndaj detyrës zyrtare, si dhe vepra penale falsifikim i dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit kompjuterik, përdorimit të dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë si dhe mosrespektim ndaj Kodit Penal.
 7. Deklaratë nga personi fizik, se tre vitet e fundit nuk ka kryer funksionin e një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në kompani të sigurimeve ose person tjetër juridik ndaj të cilit është nisur administratë speciale, ose kundër të cilës është filluar procedurë e falimentimit ose të likuidimit;
 8. Dëshmi se personi fizik nuk është person i lidhur me personin juridik në të cilin kompania e sigurimeve (në të cilën personi synon të sigurojë pjesëmarrje të kualifikuar) zotëron drejtpërdrejt ose indirekt të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit në atë person, dhe atë:
 - 8.1 Deklaratë nga personi fizik se personi fizik nuk është person i lidhur me personin juridik në të cilin kompania e sigurimeve, drejtpërdrejt ose indirekt, zotëron të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit në atë person;
 - 8.2 Listë e personave juridikë në të cilët personi fizik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesëve, e nënshkruara nga personi fizik;
 - 8.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik për atë se te cilët persona të tjerë juridikë personi fizik posedon aksione;
 - 8.4 Dëshmi nga Regjistri qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi fizik mban pjesë (aksione) në persona të tjerë juridikë;
 - 8.5 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik, për atë se ku personi fizik është anëtar i një organi drejtues, i një organi mbikëqyrës,

prokurues ose person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në persona të tjerë juridikë;

9. Deklaratë e personit fizik se nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
10. Vërtetim i tarifës së paguar për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompaninë e sigurimeve, në përputhje me Tarifën e Agjencisë dhe
11. Dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë kredituese (bonitetit) të personit fizik.

(6) Dokumentacionin nga paragrafi (3) pikat 5) dhe 6), pika 7) nën-pika 7.1, pika 8) nënpikat 8.3, 8.4 dhe 8.6 dhe pikat 12) dhe 13 dhe paragrafi (5) pika 5) dhe pika 8) nënpikat 8.3, 8.4 dhe 8.5 të këtij neni, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga aplikuesi), për të cilin aplikuesi do të jepë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në formularin K-PPK-SHS (Deklarata është një pjesë përbërëse e Formularit K-PPK-SHS) i cili është dhënë në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje dhe në Agjenci dorëzon dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur me shumën e përcaktuar nga Tarifa e përcaktuar me ligj.

(7) Vërtetimin nga paragrafi (5) pika 6 të këtij neni, Agjencia zyrtarisht do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga kërkuesi). Nëse personi është person i huaj, ai/ajo është e detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj .

(8) Kur vendoset në bazë të dokumentacionit të paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni, vlerësohet nëse personi që synon të marrë aksione në shoqërinë e sigurimeve i përmbush kriteret e përcaktuara me Ligjin për mbikëqyrjen e sigurimeve, së paku nëpërmjet:

- verifikimit të identitetit të personave që synojnë të marrin pjesë të kualifikuar në kompani të sigurimit, personave të cilët lidhen me to dhe formën e tyre ligjore;
- verifikimit nëse pozicioni financiar i personave që synojnë të marrin pjesë të kualifikuar në kompani të sigurimit është e përshtatshme në raport me vlerën e aksioneve që ata synojnë t'i fitojnë;
- verifikimit të burimeve të fondeve, prejardhjes dhe ligjshmërisë së tyre;
- vlerësimit të mundësive për mbështetje të rritjes së planifikuar të fondeve të veta të kompanisë së sigurimit nga ana e personave që synojnë të marrin pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve;
- vlerësimit të rregulloreve dhe praktikave të vendit të origjinës së personit që synon të marrë pjesë të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve nga aspekti nëse Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të kryejë në mënyrë efektive funksionin mbikëqyrës dhe nëse do të mund të bashkëpunojë me organin kompetent mbikëqyrës të këtij vendi për sa i përket respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit për kryerjen e mbikëqyrjes efektive (në rastin e një personi të huaj që synon të marrë aksione në një kompani të sigurimit);
- verifikimit që shkalla e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave të vendit të origjinës së personit që synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimit me standarde ndërkombëtare në fushën e financave, raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimin e pastrimit të parave, etj., nuk tregon mundësi të ekzistimit të rrezikut të lartë që mund të rrezikonte stabilitetin, besueshmërinë dhe reputacionin e kompanisë së sigurimeve, d.m.th. funksionimin e saj në përputhje me rregulloret (në rast të personit të huaj që synon të fitojë aksione në kompaninë e sigurimit);
- verifikimit nëse në kërkesë ka mospërputhje që nuk mund të shpjegohen

(9) Sa i përket kërkesës për dhënie të pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar nga një person që i

përvetëson aksionet në bazë të vendimit të organit kompetent në përputhje me ligjin, dokumentacionit që duhet të sigurohet nga ai person dhe procedurës së vlerësimit, zbatohet siç duhet dispozitat e përmendur në paragrafët (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni.

(10) Për kërkesën e paragrafit (1) të këtij neni, Agjencia merr vendim për dhënien e pëlqimit ose refuzimin e kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

III. PËLQIM PËR PJESËMARRJE TË KUALIFIKUAR NË SHOQËRI PËR BROKERIM NË SIGURIME, GJEGJËSISHT NË SHOQËRI PËR PËRFAQËSIM NË SIGURIME Neni 3

(1) Për dhënien e pëlqimit për të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht në kompani për përfaqësim në sigurime, në Agjenci dorëzohet kërkesa për marrjen e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimit ose brokerimit, gjegjësisht në shoqërinë për përfaqësim në sigurime.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni do të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë: "Kërkesë për pëlqim për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri për brokerim në sigurim gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurim (Formulari K-PPK-SHBS/SHP", e cila është bashkangjitur në Aneksin 4 të kësaj rregulloreje dhe është pjesë e saj përbërëse.

(3) Nëse personi që synon të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të brokerimit në sigurime gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime është person juridik, kërkesës së paragrafit (1) të këtij neni i bashkangjitet dokumentacioni vijues:

1. Pyetësor i plotësuar për personat juridikë në një formular të përshtatshme të caktuar që jepet në Aneksin 2 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
 - 1.a Të dhëna për numrin e aksioneve që personi synon t'i marrë në shoqërinë për brokerim në sigurime, gjegjësisht në shoqërinë për përfaqësim në sigurim, të dhëna për numrin e aksioneve që personi ndoshta tashmë i posedon në atë shoqëri, si dhe të dhëna për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e kompanisë para dhe pas përvetësimit të aksioneve;
2. Vendim i organit kompetent të personit juridik për pjesëmarrje në themelimin e kompanisë/shoqërisë për brokerim në sigurime, përkatësisht agjencisë për përfaqësim në sigurime, i sjellë nga organi kompetent i personit juridik;
3. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë;
 - 3.1 Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik mbi origjinën e mjeteve me të cilat personi juridik do t'i marrë aksionet në shoqërinë për brokerim në sigurime gjegjësisht shoqërinë për përfaqësim në sigurime; dhe
 - 3.2 Dëshmi adekuate për burimin e fondeve me të cilat personi juridik do t'i përvetësojë aksionet në shoqërinë e sigurimeve me shumë të paktën të barabartë me vlerën nominale të aksioneve që i nënshtrohen përvetësimit (raport auditiv për personin juridik, bilanc ose dëshmi tjetër të përshtatshme).
4. Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që kundër personit juridik nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
5. Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik që konfirmon se personit juridik nuk i është shqiptuar asnjë dënim sekondar dhe atë ndalesë për marrjen e lejes për themelimin dhe punën e kompanisë së sigurimit, anulim të lejes për themelimin dhe punën e kompanisë së sigurimit, ndalesë për themelimin e personave të ri juridikë dhe ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerjen e veprimtarive të sigurimit;
6. Dëshmi se nuk është filluar procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personit juridik, si vijon:

- 6.1 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë institucion tjetër kompetent se asnjë veprim i falimentimit ose likuidimit nuk është filluar kundër personit juridik;
- 6.2 Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik se kundër personit juridik nuk ka filluar procedurë falimentimi ose procedurë likuidimi;
- 7. Dëshmi se personi juridik nuk është person i lidhur me person tjetër juridik me të cilin kompania (shoqëria) për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompania për përfaqësim në sigurime (në të cilën personi synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar) posedon drejtpërdrejt ose indirekt të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit për këtë person, dhe atë:
 - 7.1 Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik, se personi juridik nuk është person i lidhur me person tjetër juridik në të cilin kompania për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompania për ndërmjetësim në sigurime (në të cilën personi synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar) posedon drejtpërdrejt ose indirekt të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit për atë person;
 - 7.2 Listë e personave të cilët në personin juridik posedojnë drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, e nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
 - 7.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë, gjegjësisht nga ndonjë regjistër tjetër publik lidhur me atë se kush janë bartës të aksioneve, gjegjësisht kush ka pjesë tek personi juridik;
- Listë e personave juridikë në të cilët personi juridik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë, e nënshkruar nga personi i autorizuar i personit juridik;
- 7.4 Dëshmi nga Regjistri Qendror i letrave me vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilët persona të tjerë juridikë personi juridik posedon aksione;
- 7.5 Dëshmi nga Regjistri Qendror, respektivisht ndonjë regjistër tjetër publik se ku personi juridik posedon ose zotëron pjesë (aksione) në persona të tjerë juridikë;
- 8. Deklaratë e organit kompetent të personit juridik, se personi juridik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 9. Deklaratë nga organi kompetent i personit juridik, se personi juridik nuk është person i lidhur me kompani të sigurimit, me kompani të tjera të brokerimit në sigurim, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime sipas nenit 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve;
- 10. Akti për themelim gjegjësisht Statuti i personit juridik;
- 11. Listë e anëtarëve të organit drejtues të personit juridik (Certifikatë nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër relevant publik);
- 12. Certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar zyra qendrore e personit juridik;
- 13. Kopje e librit të aksioneve;
- 14. Raport auditiv (Raport për auditimin e kryer të pasqyrave financiare të kompanisë) i përpiluar nga kompania e autorizuar për revizion për dy vitet e fundit të punës për personin juridik. Personat juridikë të cilët janë themeluar dhe operojnë për më pak se dy vite detyrohen të dorëzojnë Raport të revizionit ose auditimit të kryer për pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën për të cilën kanë punuar, me gjendjen me datë më së shumti një muaj para dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes, si dhe të dorëzojnë raporte revizore për dy vitet e fundit të punës për aksionarët e tyre- persona juridikë, d.m.th. të dorëzojnë dokumentacionin përkatës të paragrafit (4) të këtij neni për aksionarët e tyre - persona fizikë, të cilët marrin pjesë në kapitalin e personit juridik me mbi 10%;
- 15. Dëshmi për tarifën e paguar për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të brokeirimit në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime, në përputhje me Tarifën e Agjencisë dhe
- 16. Dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë pagueuse të personit juridik, si dhe vlerësimin e aksionarëve të tij, d.m.th. të mbajtësve të pjesëve/aksioneve.

(4) Nëse personi që synon të fitojë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompaninë për brokerim në

sigurim, gjegjësisht kompaninë për përfaqësim në sigurim është person fizik, kërkesës së paragrafit (1) të këtij neni i bashkangjitet dokumentacioni vijues:

1. Pyetësor i plotësuar për personat fizikë në një formular të përshtatshme të përcaktuar të dhënë në Aneksin 2 të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj; Plotësohen të dhëna (emri dhe mbiemri, vendbanimi dhe adresa si dhe numëri i letërnjoftimit) për personin fizik të marra nga letërnjoftimi, gjegjësisht dorëzohet kopje e pasaportës për personin fizik të huaj. Bashkangjitur me të dhënat për personin fizik, të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet deklaratë nga personi se ato janë të dhënat e tij dhe se janë të sakta, e vërtetuar nga ana e personit të autorizuar (noter);
2. Të dhëna për numrin e aksioneve të cilat personi synon t'i marrë në shoqërinë për brokerim në sigurime, gjegjësisht në shoqërinë për përfaqësim në sigurime, të dhëna për numrin e aksioneve që personi ndoshta tashmë i posedon në atë shoqëri, si dhe të dhëna për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e kompanisë para dhe pas përvetësimit të aksioneve
3. Burimet e mjeteve për pagesën e kapitalit, dhe atë;
 - 3.1. Deklaratë nga personi fizik për origjinën e mjeteve me të cilat do të marrë aksione në shoqërinë për brokerim në sigurime gjegjësisht shoqërinë për përfaqësim në sigurime; dhe
 - 3.2. Dëshmi e duhur për burimin e mjeteve të cilat personi fizik do të përvetësojë aksione në shoqërinë për brokerim në sigurime, gjegjësisht shoqërinë për përfaqësim në sigurime me shumë së paku të barabartë me vlerën nominale të aksioneve të cilat janë lëndë e përvetësimit (vërtetim për të ardhurat e realizuara të lëshuar nga organi kompetent tatimor, dokument për shumën e rrogës dhe të ardhurave të realizuara në baza të tjera, vërtetim për trashigimi, vërtetim nga banka ose ndonjë institucion tjetër financiar për shumën dhe datën e mjeteve të investuara dhe dëshmi tjetër përkatëse);
4. Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë ose ndonjë regjistër tjetër publik që nuk ka sanksione kundërvajtëse ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e sigurimeve dhe financave;
5. Vërtetim e dëshmisë penale nga gjykata kompetente se personi nuk është dënuar me aktgjykim gjyqësor fuqiplotë me dënim me burg pa kusht për më shumë se gjashtë muaj, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike të vendimit, për vepra penale kundër patundshmërisë, vepra penale kundër financave publike, operacioneve të pagesës dhe ekonomisë, vepra penale ndaj detyrës, si dhe vepra penale falsifikim i dokumenteve, raste të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit kompjuterik, përdorimi i dokumenteve me përmbajtje të pavërtetë si dhe mosrespektim ndaj Kodit Penal.
6. Deklaratë nga personi fizik, se tre vitet e fundit nuk ka kryer funksionin e një personi me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në kompani të sigurimeve ose person tjetër juridik ndaj të cilit është zbatuar administratë e veçantë, ose kundër të cilës janë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit;
7. Dëshmi se personi fizik nuk është person i lidhur me person tjetër juridik me të cilin kompania (shoqëria) për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompania për përfaqësim në sigurim (në të cilën personi synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar), posedon drejtpërdrejt ose indirekt të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit për atë person, dhe atë:
 - 7.1 Deklaratë nga personi fizik se personi fizik nuk është person i lidhur me personin juridik në të cilin kompania për brokerim në sigurim gjegjësisht kompania për përfaqësim në sigurim, drejtpërdrejt ose indirekt, zotëron të paktën 10% të kapitalit ose të drejtave të votimit për atë person;
 - 7.2 Listë e personave juridikë në të cilët personi fizik posedon drejtpërdrejt ose indirekt më shumë se 10% të aksioneve, e nënshkruar nga personi fizik;
 - 7.3 Dëshmi nga Regjistri Qendror i Letrave me Vlerë ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilët persona të tjerë juridikë personi fizik posedon aksione;
 - 7.4 Dëshmi nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik se te cilat persona juridikë personi fizik ka pjesë (aksione);

- 7.5 Vërtetim nga Regjistri Qendror ose ndonjë regjistër tjetër publik, për atë se ku personi fizik është anëtar i një organi drejtues, i një organi mbikëqyrës, prokurues ose person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në persona të tjerë juridikë;
8. Deklaratë e personit fizik se personi fizik nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
9. Deklaratë nga personi fizik se nuk është person i lidhur me kompani të sigurimit, me kompani të tjera për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime sipas nenit 16-a të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve;
10. Dëshmi për tarifën e paguar për dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime, në përputhje me Tarifën e Agjencisë dhe
11. Dëshmi të tjera për vlerësimin e aftësisë kredituese (bonitetit) të personit fizik.

(5) Dokumentacionin nga paragrafi (3) pikat 4) dhe 5), pika 6) nënpika 6.1, pika 7) nënpikat 7.3, 7.5 dhe 7.6, pikat 12) dhe 13 dhe paragrafi (4) pika 4) dhe pika 7) nënpikat 7.3, 7.4 dhe 7.5 të këtij neni, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti nuk dorëzohet nga aplikuesi), për të cilin aplikuesi do të japë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në formularin K-PPK-SHBS/SHP (Deklarata është një pjesë përbërëse e Formularit K-PPK-SHBS/SHP) i cili është dhënë në Aneksin 4 të kësaj Rregulloreje dhe deri te Agjencia dorëzohen dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur në shumën e përcaktuar nga Tarifa e përcaktuar me ligj.

(6) Vërtetimin nga paragrafi (4) pika 6 të këtij neni, Agjencia zyrtarisht do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga aplikuesi). Nëse personi është person i huaj, ai / ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj.

(7) Kur vendoset në bazë të dokumentacionit të paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni, vlerësohet nëse personi që synon të marrë aksione në shoqërinë për brokerim në sigurime, gjegjësisht shoqërinë për përfaqësim në sigurime i përmbush kriteret e përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, së paku nëpërmjet:

- verifikimit të identitetit të personave që synojnë të marrin pjesë të kualifikuar në kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime, personave të cilët lidhen me to dhe formën e tyre ligjore;
- verifikimit nëse pozicioni financiar i personave që synojnë të marrin pjesë të kualifikuar në kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime është i përshtatshme në raport me vlerën e aksioneve që ata synojnë t'i fitojnë;
- verifikimit të burimeve të fondeve, prejardhjes dhe ligjshmërisë së tyre;
- vlerësimit të mundësive për mbështetjen e rritjes së planifikuar të fondeve të veta të kompanisë për brokerim në sigurime, gjegjësisht shoqërisë për përfaqësim në sigurim nga personat që synojnë të fitojnë pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri për sigurime;
- vlerësimit të rregulloreve dhe praktikave të vendit të origjinës së personit që synon të marrë pjesë të kualifikuar në shoqëri për brokerim në sigurime, gjegjësisht shoqëri për përfaqësim në sigurime për sa i përket faktit nëse Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve mund të kryejë në mënyrë efektive funksionin mbikëqyrës dhe nëse mund të bashkëpunojë me organin kompetent mbikëqyrës të këtij vendi për sa i përket respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit për kryerjen e mbikëqyrjes efektive (në rastin e një personi të huaj që synon të marrë aksione në një kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime)
- verifikimit që shkalla e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave të vendit të origjinës së personit që synon të fitojë pjesëmarrje të kualifikuar në kompani për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime me standarde ndërkombëtare në fushën e

financave, raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimin e pastrimit të parave, etj., nuk tregon mundësi për ekzistimin e rrezikut të lartë që mund të rrezikonte stabilitetin, besueshmërinë dhe reputacionin e kompanisë për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompanisë për përfaqësim në sigurime, d.m.th. funksionimin e saj në përputhje me rregulloret (në rast të personit të huaj që synon të fitojë aksione në kompaninë e sigurimit);

- verifikimit nëse në kërkesë ka mospërputhje që nuk mund të shpjegohen

(8) Sa i përket kërkesës për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar nga personi që i përvetëson aksionet në bazë të vendimit të organit kompetent në përputhje me ligjin, dokumentacionit që duhet të sigurohet nga ai person dhe procedurës së vlerësimit, do të zbatohen siç duhet dispozitat e këtyre paragrafeve (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni.

(9) Për kërkesën e paragrafit (1) të këtij neni, Agjencia merr vendim për dhënien e pëlqimit ose refuzimin e kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

III. DEFINIMI I FORMËS SË DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE RREGULLIMI I PUNËVE TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E RREGULLORES

Neni 4

(1) Kërkesës për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani (shoqëri) për brokerim në sigurime, gjegjësisht kompani për përfaqësim në sigurime, i bashkangjiten të dhëna për personin e autorizuar për kontakt me Agjencinë (emri dhe mbiemri, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike).

(2) Dokumentacioni që dorëzohet me kërkesën për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani për brokerim në sigurime, dhe kompani për përfaqësim në sigurime, duhet të jetë në formë origjinale ose i kopjuar por i vërtetuar nga personi i autorizuar (noter), i firmosur nga personi i autorizuar ose nga organi kompetent, pa korrigjime të mëtutjeshëm, në gjuhën maqedonase dhe e njëjta nuk guxon të jetë më e vjetër se gjashtë muaj në ditën e dorëzimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit. Nëse dokumenti që duhet të dorëzohet është në një gjuhë tjetër, bashkë me dokumentin origjinal dorëzohet edhe forma e përkthyer në gjuhën maqedonase, e përkthyer nga një përkthyes i certifikuar dhe e vërtetuar në noter.

(3) Deklaratat dhe pyetësorët që janë pjesë të dokumentacionit që dorëzohet me kërkesën për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani për brokerim në sigurime, dhe kompani për përfaqësim në sigurime, duhet të jenë të vërtetuar nga personi i autorizuar (noter) dhe të njëjtat nuk guxojnë të jenë më e vjetër se gjashtë muaj në ditën e dorëzimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit.

(4) Nëse legjislacioni i vendit të origjinës së personit të huaj që synon pjesëmarrjen e kualifikuar e rregullon ndryshe lëndën lidhur me dokumentacionin që dorëzohet me kërkesën për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani për brokerim në sigurim, dhe kompani për përfaqësim në sigurim, atëherë duhet të dorëzohet dokumenti i duhur ose mendim juridik nga avokati me çka do të mund të vërtetohet dallimi i rregullativës, gjegjësisht do të sigurohet dokument tjetër me çka do të vërtetohet plotësimi i detyrimit të paraparë ligjor.

(5) Agjencia shqyrton dhe vendos për kërkesën për lëshimin e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani për brokerim në sigurim, dhe kompani për përfaqësim në sigurim me dokumentacion të plotë. Me dokumentacionin e plotë nënkuptojmë dokumentacionin e përcaktuar me këtë rregullore, dokumentacionin i cili në mënyrë plotësuese kërkohet nga Agjencia, si dhe dokumentet, të dhënat dhe informatat e përshtatshme të cilat duhet të merren nga insitucionet kompetente vendore

dhe të huaja në vend dhe jashtë tij.

Vendimmarrja për kërkesën për marrjen e të drejtës për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri për brokerim në sigurime, dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime

Neni 5

(1) Me rastin e vendimarrjes për kërkesën për dhënien e miratimit për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri/kompani të sigurimeve, kompani për brokerim në sigurime dhe kompani për përfaqësim në sigurime, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve vlerëson nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

(2) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve merr vendim për dhënien e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar ose për refuzimin e kërkesës, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës me dokumentacion të plotë në përputhje me këtë rregullore.

IV: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 5 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 35/2017)

Aneksi 1 zëvendësohet me ankes të ri Aneksi 1 që i është bashkangjitur kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Pas Anekseve 2 dhe 3 shtohet edhe një aneks i ri Aneksi 4, i cili i bashkangjitet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 6 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 35/2017)

Kjo rregullore hynë në fuqi një ditë pas ditës së shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 3 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 138/2017)

Kjo rregullore hynë në fuqi një ditë pas ditës së shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 3 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 69/2019)

Aneksi 1 dhe 4 zëvendësohen me anekse të reja Anekset 1 dhe 4 të cilat i bashkangjiten kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse të saj.

Neni 4 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 69/2019)

Kjo rregullore hynë në fuqi një ditë pas ditës së shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve
Klime Poposki**

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJEN E SIGURIMEVE

KËRKESË¹

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PJESËMARRJE TË KUALIFIKUAR NË SHOQËRI (KOMPANI) TË SIGURIMEVE

1.	Emri dhe mbiemri ose emërtimi i personit që synon të ketë pjesëmarrje të kualifikuar	
2.	Numri dhe vlera e aksioneve që një person tashmë i posedon në kompaninë	
3.	Numri dhe vlera nominale e aksioneve që personi synon t'i përvetësojë në shoqëri/kompani	
4.	Numri total dhe shuma nominale e aksioneve që personi do të ketë pas përvetësimit	
5.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
5.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
5.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	
5.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj/kërkojmë nga Agjencia e Mbikëqyrje të Sigurimeve të na japë pëlqim për pjesëmarrje të kualifikuar në kompaninë e sigurimit _____ (emërtimi i kompanisë).

Kërkesës i bashkangjis/bashkangjissim dokumentacionin sipas nenit 2 paragrafët (3), (4) dhe (5) të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e pjesëmarrjes së kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani të brokerimit në sigurime dhe kompani për përfaqësim në sigurime² dhe atë (secili dokument radhitet veçmas):.

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

¹Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbiqëqyrjes së Sigurimeve . www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

²Dokumentacionin nga neni 2 paragrafi (3) pika 5) dhe 6), pika 7) nënpika 7.1, pika 8) nënpikat 8.3, 8.5 dhe 8.6 dhe pikat 12) dhe 13) dhe paragrafi (5) pika 5) dhe pika 8) nënpikat 8.3, 8.4 dhe 8.5 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për marrjen ose fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëri të sigurimit, shoqëri të brokerimit në sigurime dhe shoqëri ose kompani për përfaqësim në sigurime, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti dokumentacion nuk dorëzohet nga kërkuesi ose parashtruesi) për të cilën parashtruesi ose kërkuesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emërin e tij/saj dhe në llogarinë të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në këtë Formular dhe në Agjenci dorëzohet dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur me shumën e përcaktuar nga tarifa e përcaktuar me ligj. Vërtetimin nga neni 2 paragrafi (5) pika 6 të këtij neni, Agjencia zyrtarisht do ta marrë nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk parashtrohet nga aplikuesi. Nëse personi është person i huaj, ai / ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj .

10. _____
11. _____
12. _____
13. _____

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me parashtrimin e kësaj kërkesë, Deklaroj që të dhënat dhe informacionet në këtë kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni që i bashkangjis kërkesës për dhënie e lejes për të kryer aktivitete sigurimi, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë kërkesë, si dhe të dokumenteve të bashknagjitura me këtë kërkesë, për një afat kohor prej 3 ditë pune nga bërja e ndryshimit, do të njoftojë Agjencinë.

Me dorëzimin ose parashtrimin e kësaj kërkesë, unë jam dakord të përdoren të dhënat e mia personale të përfshira në këtë kërkesë në procedurën për realizimin e të drejtës time pranë organeve kompetente për të marrë dëshmi dhe të dhëna të nevojshme nga institucionet e tjera në mënyrë zyrtare dhe të njëjtat të përdoren në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Data dhe vendi i dorëzimit

_____. 20 _____

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës²

² Kërkesën e firmosin personat fizikë ose përfaqësuesit e autorizuar të personave juridikë që synojnë të marrin të drjetën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani të sigurimit.

PYETËSOR

për personat juridikë që synojnë të marrin të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimit, shoqëri të brokerimit në sigurim, dhe shoqëri për përfaqësim në sigurim

TË DHËNA PËR PLOTËSIMIN E PYETËSORIT:

Pyetëtori është për personin e autorizuar të organit kompetent të personit juridik i cili synon të fitojë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri/kompani të sigurimeve, kompani të brokerimit në sigurime dhe kompani për përfaqësim në sigurime (në tekstin e mëtejme: shoqëria).

Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve . <http://www.aso.mk>.

Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

Është e nevojshme t'iu përgjigjeni të gjitha pyetjeve të dhëna në Pyetësor, dhe ato pyetje që nuk janë të zbatueshme duhet të shënohen siç duhet me TË PAZBATUESHME. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme në Pyetësor për përgjigje të hollësishme, atëherë pyetësorit mund t'i bashkëngjitni shtojcë (në formë të shtypur) e cila do të shënohet me numrin e pyetjes për të cilën është përgjigja.

Personi që plotëson Pyetësorin është i detyruar të njoftojë menjëherë Agjencinë nëse në çdo kohë pas dorëzimit të Pyetësorit në Agjenci ndodh një ndryshim i rëndësishëm në të dhënat e dhëna në këtë pyetësor. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i ndërmarrë nga personi që nënshkruan këtë pyetësor.

PJESA 1: TË DHËNA PERSONALE

1.1. Emri i personit juridik

1.2. Selia

1.3. Numri tatimor

1.4. Numri personal (ose numri përkatës i identifikimit, në përputhje me rregulloret e vendit të huaj - për person juridik të huaj)

1.5. Telefon, posta elektronike dhe adresa e internetit (nëse personi juridik ka një adresë të tillë)

1.6. Veprimtaria kryesore, sipas klasifikimit kombëtar të veprimtarive ose sipas klasifikimit të veprimtarive në fuqi në vend të huaj (për person juridik të huaj).

PJESA 2: TË DHËNA TË TJERA TË RËNDËSISHME

2. Radhitni personat që janë anëtarë të organit drejtues dhe të bordit mbikëqyrës të personit juridik, me përshkrim të shkurtër të arsimimit dhe përvojës së tyre aktuale në punë.

Emri dhe mbiemri	Organi drejtues ose organi mbikëqyrës	Arsimi	Përvoja e punës

3. Citoni personat (persona juridikë dhe persona fizikë) të cilët në personin juridik posedojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë.

Emri dhe mbiemri i personit fizik / Emri (titulli) i personit juridik	Adresa / Selia	Veprimtaria kryesore	Pjesëmarrja në kapital ose në të drejtat e votimit shprehur në përqindje

4. A kanë personat nga pika 3 e këtij pyetësi përfaqësues të tyre në organet drejtuese ose mbikëqyrëse të personit juridik?

Po

Jo

4.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi citoni personat dhe përfaqësuesit e tyre në organet mbikëqyrëse ose drejtuese të personit juridik që synon të fitojë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani.

Emri dhe mbiemri /titulli	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit	Organi drejtues ose organi mbikëqyrës

5. Citoni personat juridikë ku personi juridik posedon, drejtpërdrejt ose indirekt, më shumë se 10% të aksioneve, d.m.th. pjesë.

Emri dhe selia	Veprimtari themelore	Pjesëmarrja në kapital ose në të drejtat e votimit të personit juridik shprehur në përqindje

Emri dhe selia	Veprimtari themelore	Pjesëmarrja në kapital ose në të drejtat e votimit të personit juridik shprehur në përqindje

Për të gjithë këto individë dorëzohen pasqyra financiare për tre vitet e fundit të punës

6. A ka personi juridik përfaqësues të vet në organet për mbikëqyrje ose ato drejtuese nga pika 5 e këtij pyetësi?

Po

Jo

6.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi citoni personat juridikë dhe përfaqësuesit e personit juridik i cili synon të marrë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri në organet e saj mbikëqyrëse ose drejtuese.

Emri dhe selia	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të personit juridik	Organi drejtues ose organi mbikëqyrës

7. A ka personi juridik përfaqësues të vet në organet e mbikëqyrjes ose menaxhimit apo në ndonjë mënyrë tjetër ushtron ndikim në menaxhimin dhe sjelljen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare të ndonjë personi tjetër juridik në Republikën e Maqedonisë ose jashtë saj?

Po

Jo

7.1. Citoni personat juridikë, organet dhe personat që e përfaqësojnë personin juridik.

Emri dhe selia e personit juridik	Organi për mbikëqyrje ose menaxhim	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të personit juridik	Mënyrë tjetër e ushtrimit të ndikimit

8. Tek personi juridik a merr pjesë ndonjë person i cili me vendim fuqplotë nga gjykata është dënuar me burgim për një vepër të kryer penale? Nëse po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

9. A i është shqiptuar personit juridik ndonjë sanksion kundërvajtës, pra ndalesë ndëshkuese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detytës? Nëse një sanksion apo ndalesë e tillë është shqiptuar, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

9.1. A është shqiptuar një sanksion i tillë, gjegjësisht një ndalesë e tillë ndaj personit që merr pjesë në personin juridik? Nëse një sanksion apo ndalesë e tillë është shqiptuar, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

10. A është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj pasurisë së personit juridik, apo ndaj personit që merr pjesë në personin juridik? Ju lutemi radhitni për imtësisht të gjitha rrethanat që lidhen me këtë procedurë.

11. A është personi i cili lidhet me personin juridik aksionar ose anëtar i organit mbikëqyrës ose drejtues të ndonjë kompanie për sigurim/kompanie për brokerim në sigurim/ kompanie për përfaqësim në sigurim, banke ose institucioni tjetër financiar?

Po

Jo

11.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi specifikoni për imtësisht:

Emri dhe mbiemri/ titulli dhe selia e personit të lidhur	Emri dhe selia e kompanisë/ institucionit financiar/	Pjesëmarrja shprehur në përqindje	Organi për mbikëqyrje ose menaxhim	Të dhëna të tjera të rëndësishme

12. A ka qenë e hapur procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personave juridikë ku personi juridik ka marrë pjesë ose kishte një përfaqësues në organet e mbikëqyrjes ose menaxhimit ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në menaxhimin dhe sjelljen e politikave dhe të vendimeve financiare dhe tregtare?

Po

Jo

12.1. Nëse po, ju lutemi jepni më shumë detaje.

13. A janë marrë masa nga organi përgjegjës supervizor ndaj shoqërisë ose ndonjë institucioni tjetër financiar në të cilin personi juridik ka marrë pjesë ose ka pasur një përfaqësues në organet e tij mbikëqyrëse ose drejtuese ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në menaxhimin dhe sjelljen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare?

Po

Jo

13.1. Nëse po, ju lutemi tregoni masat dhe detajet në lidhje me zbatimin ose moszbatimin e tyre?

14. A janë marrë masa nga organi përgjegjës supervizor ndaj kompanisë ose shoqërisë ose ndonjë institucioni tjetër financiar në të cilin pjesëmarrje ka personi i cili në të njëjtën kohë ka pjesëmarrje edhe në personin juridik ose në të cilin ky person ka pasur përfaqësuesin e vet në organet mbikëqyrëse ose drejtuese ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në menaxhimin dhe sjelljen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare?

Po

Jo

14.1. Nëse po, ju lutemi tregoni masat dhe detajet në lidhje me zbatimin ose moszbatimin e tyre?

15. A është personi juridik, apo personi që ka pjesëmarrje në personin juridik, i lidhur me persona të tjerë të cilët së bashku me personin juridik synojnë të marrin të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani?

Po

Jo

15.1. Tregoni në cilën mënyrë.

16. A ka ndodhur ndonjëherë që organi përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive për sigurim dhe institucioneve të tjera financiare t'i revokojë personit juridik pëlqimin për aksionar apo për pjesëmarrje në kapitalin e ndonjë kompanie tjetër të sigurimeve ose të ndonjë institucioni tjetër financiar, ose t'i

revokoj të drejtën që të jetë anëtar ose të ketë përfaqësuesin e vet në organin mbikëqyrës ose drejtues të asaj shoqërie sigurimi ose institucioni financiar?

Po

Jo

16.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

17. A ka ndodhur ndonjëherë që organi përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive për sigurim dhe institucioneve të tjera financiare t'i revokojë personit që ka pjesëmarrje në personin juridik pëlqimin për aksionar apo për pjesëmarrje në kapitalin e ndonjë kompanie tjetër të sigurimeve ose të ndonjë institucioni tjetër financiar, ose t'i revokoj të drejtën që të jetë anëtar ose të ketë përfaqësuesin e vet në organin mbikëqyrës ose drejtues në atë bankë ose institucion financiar?

Po

Jo

17.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

18. A konsideroni se ka fakte ose rrethana të tjera që mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e aftësisë së personit juridik për të qenë aksionar i kompanisë dhe të sigurojë funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të kompanisë?

19. Jepni një përshkrim të shkurtër se ku e shihni kompaninë/shoqërinë pas pesë vite pune.

DEKLARATË

Unë / Ne _____ (emri dhe mbiemri i të gjithë personave, anëtarëve të organit mbikëqyrës ose drejtues të personit juridik që synon të ketë pjesëmarrje të kualifikuar në kompani) si anëtar / anëtarë të _____ (organi mbikëqyrës ose drejtues i personit juridik) të _____ (emri (titulli) i personit juridik)

a) Deklaroj / deklarojmë, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, që të dhënat e përfshira në këtë pyetësor, si dhe i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga personi juridik brenda kornizës së kërkesës për dhënie e pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të rrejshme ose false.

b) Jam/jemi në dijeni të kriterëve të përcaktuara me Ligjin për mbikëqyrjen e sigurimeve që duhet të përmbushen nga _____ (titulli i personit juridik) për t'u bërë një aksionar i kualifikuar në kompani.

c) Deklaroj/deklarojmë që personi juridik do të sigurojë pajtueshmëri me standardet e mbikëqyrjes, do të zbatojë masat e marra nga Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe do t'i dorëzojë të gjitha të dhënat dhe informacionet të kërkuara nga Agjencia për të kryer mbikëqyrje efektive, duke siguruar kështu funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të kompanisë.

Vendi dhe data

**Nënshkrimi i anëtarëve të
organit kompetent për administrimin e personit juridik**

PYETËSOR

për personat fizikë që synojnë të fitojnë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të sigurimit, shoqëri të brokerimit në sigurim dhe shoqëri për përfaqësim në sigurim

TË DHËNA PËR PLOTËSIMIN E PYETËSORIT:

Pyetësoni plotësohet personalisht nga personi i cili synon të fitojë të drejtën për pjesëmarrje të kualifikuar në kompani/shoqëri të sigurimeve, kompani/shoqëri të brokerimit në sigurim dhe kompani/shoqëri për përfaqësim në sigurim (në tekstin e mëtejme: shoqëria).

Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve . <http://www.aso.mk>.

Nëse Pyetësoni nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

Është e nevojshme t'iu përgjigjeni të gjitha pyetjeve të dhëna në Pyetëson dhe ato pyetje që nuk janë të zbatueshme duhet të shënohen siç duhet me TË PAZBATUESHME. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme në Pyetëson për përgjigje të hollësishme, atëherë pyetësonit mund t'i bashkëngjitni shtojcë (në formë të shtypur) e cila do të shënohet me numrin e pyetjes për të cilën është përgjigja.

Personi që plotëson Pyetësonin është i detyruar të njoftojë menjëherë Agjencinë nëse në çdo kohë pas dorëzimit të Pyetësonit në Agjenci ndodh një ndryshim i rëndësishëm në të dhënat e parqituara në këtë pyetëson. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i ndërmarrë nga personi që nënshkruan këtë pyetëson.

PJESA 1: TË DHËNA PERSONALE

1. 1. Emri dhe mbiemri

1.2. Adresa e shtëpisë:

1.3. Adresa në Republikën e Maqedonisë (në rast të personit të huaj që banon në Republikën e Maqedonisë).

1.4. Data dhe vendi i lindjes:

1.5. Shtetësia:

1.6. Numri i letërnjoftimit ose numrin e pasaportës (për persona fizikë të huaj):

1.7. Telefon:

1.8. Adresa e postës elektronike

PJESA 2: TË DHËNA PËR ARSIMIN

2. Shënoni të dhënat për arsimin e mbaruar me datën e duhur të përvetësimit dhe emrin e institucionit arsimor (universiteti / fakulteti) ku është mbaruar arsimi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në tabelë:

Emri i institucionit arsimor	Adresa e institucionit arsimor	Titulli i arsimit (shkalla)	Viti i marrjes së diplomës

PJESA 3: HISTORIA PROFESIONALE DHE PËRVOJA

3. Radhitni të gjitha punët dhe / ose pozicionet që keni mbajtur deri në kohën e plotësimit të pyetësorit, përfshirë të dhënat e punëdhënësit, pozicionin që keni mbajtur, duke filluar me punën e fundit, siç kërkohet nga tabela më poshtë:

Periudha prej / deri (muaj / vit)	Emri, selia dhe veprimtaria kryesore e punëdhënësit	Pozicioni/ vendi i punës

PJESA 4: TË DHËNA TË TJERA RELEVANTE

4. A jeni dënuar ndonjëherë me dënim me burg për ndonjë vepër penale të kryer?

Po

Jo

4.1. Nëse keni qenë, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

5. A u është shqiptuar ndonjë sanksion kundërvajtës, pra ndalesë ndëshkuese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detytës?

Po

Jo

5.1. Nëse një sanksion apo ndalesë e tillë u është shqiptuar, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

6. A është hapur procedurë falimentimi kundër pasurisë suaj?

Po

Jo

6.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi rendhitni detajet me të gjitha rrethanat që lidhen me këtë procedurë.

7. A jeni ju ose ndonjë person i lidhur me ju aksionar, pronar, bashkëpronar ose bashkëpunëtor në ndonjë person tjetër juridik?

Po

Jo

7.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi plotësoni dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik dhe e dyta plotësohet për personat që lidhen me personin fizik

Emri/titulli dhe selia e personit juridik në të cilën personi fizik ka pjesë të kapitalit dhe / ose aksione me të drejtë vote	Përqindja e kapitalit dhe / ose aksioneve me të drejtë vote

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli i personit të lidhur	Emri/titulli dhe selia e personit juridik në të cilin personi i lidhur ka pjesë të kapitalit dhe / ose të aksioneve me të drejtë vote	Përqindja e kapitalit dhe /ose aksioneve me të drejtë vote

8. A jeni ju ose ndonjë person i lidhur me ju anëtar i organit mbikëqyrës ose drejtues në personat e përmendur më herët?

Po

Jo

8.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi plotësoni dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik dhe e dyta plotësohet për personat që lidhen me personin fizik

Emri (titulli) dhe selia e personit juridik	Organi drejtues ose organi mbikëqyrës

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri ose titulli i personit të lidhur	Emri (titulli) dhe selia e personit juridik	Organi mbikëqyrës ose drejtues

9. A jeni anëtar i organit mbikëqyrës ose drejtues ose në ndonjë mënyrë tjetër ndikoni në menaxhimin dhe sjelljen ose vendimmarrjen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare të ndonjë personi juridik, përveç personave juridikë të pikës 7 të këtij Pyetësi? Citoni ata persona juridikë, organin mbikëqyrës ose drejtues ose mënyrën se si ushtroni ndikim.

Emri dhe selia e personit juridik	Organi mbikëqyrës ose drejtues	Mënyrë tjetër e realizimit të ndikimit

10. A ka qenë e hapur procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personave juridikë në të cilët keni marrë pjesë ose keni qenë anëtar në organet e mbikëqyrjes ose menaxhimit ose në ndonjë mënyrë tjetër keni ndikuar në menaxhimin dhe vendimmarrjen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare?

Po

Jo

10.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni më shumë detaje rreth aktiviteteve tuaja për atë person juridik.

11. A është marrë ndonjë vendim gjyqësor fuqiptotë kundër jush që verifikon përgjegjësinë tuaj për hapjen e procedurës së falimentimit ose likuidimit? Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet në lidhje me vendimin gjyqësor.

12. A janë marrë masa nga organi përgjegjës supervisor ndaj kompanisë ose shoqërisë së sigurimit ose ndonjë institucioni tjetër financiar në të cilin keni marrë pjesë ose keni qenë anëtar i organit për mbikëqyrje ose menaxhim ose në ndonjë mënyrë tjetër keni ndikuar në menaxhimin dhe sjelljen e politikave dhe vendimeve financiare dhe tregtare?

Po

Jo

12.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi tregoni masat dhe detajet në lidhje me zbatimin ose moszbatimin e tyre?

13. A jeni ju, ose personi i lidhur me ju, i/e lidhur me persona të tjerë, të cilët, sipas Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, konsiderohen persona të lidhur me kompaninë?

Po

Jo

13.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi plotësoni dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik dhe e dyta plotësohet për personat që lidhen me personin fizik

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli dhe Selia e personit të lidhur me shoqërinë	Mënyra e lidhjes

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli (emri) dhe selia e personit të lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli (emri) dhe selia e personit të lidhur me shoqërinë	Mënyra e lidhjes ndërmjet personave nga kolona 1 dhe 2

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli (emri) dhe selia e personit të lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli (emri) dhe selia e personit të lidhur me shoqërinë	Mënyra e lidhjes ndërmjet personave nga kolona 1 dhe 2

14. A jeni ju, ose personi i lidhur me ju, i lidhur me anëtarët e organit drejtues ose bordit mbikëqyrës ose bordit të drejtorëve të kompanisë?

Po

Jo

14.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi plotësoni dy tabelat e mëposhtme, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik dhe e dyta plotësohet për personat që lidhen me personin fizik

Emri dhe mbiemri i anëtarit të organit drejtues ose bordit mbikëqyrës	Organi drejtues ose bordi mbikëqyrës

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht titulli (emri) dhe selia e personit të lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri i anëtarit të organit drejtues ose bordit mbikëqyrës	Organi drejtues ose bordi mbikëqyrës

15. A e ka vlerësuar ndonjëherë organi përgjegjës për mbikëqyrje të shoqërive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare reputacionin dhe aftësinë tuaj për të marrë të drejtën për pjesëmarrje në kapital ose për t'u bërë anëtar i organit mbikëqyrës ose drejtues të atyre institucioneve?

Po

Jo

15.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

Emri i organit përgjegjës mbikëqyrës	Lloji i miratimit/lejes së kërkuar	Arsyet pse nuk u dha pëlqimi (nëse organi përgjegjës nuk e lëshoi pëlqimin e kërkuar)

16. A ka ndodhur ndonjëherë që organi përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive për sigurim dhe institucioneve të tjera financiare t'ju ketë revokuar pëlqimin për aksionar apo për pjesëmarrje në kapitalin e kompanisë së sigurimit ose ndonjë institucioni tjetër financiar, ose t'ju ketë revokuar të drejtën që të jetë anëtar i organit mbikëqyrës ose organit drejtues?

Po

Jo

16.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

17. A ju ka ndodhur ndonjëherë të revokoheni ose nga ju të jetë kërkuar që të tërhiqeni nga ndonjë funksion në ndonjë person tjetër juridik?

Po

Jo

17.1. Nëse përgjigja është po, ju lutemi jepni të gjitha detajet.

18. A konsideroni se ka fakte ose rrethana të tjera që mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e aftësisë suaj për të qenë aksionar i kompanisë dhe të siguron funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të kompanisë?

19. Jepni një përshkrim të shkurtër se ku e shihni shoqërinë/kompaninë pas pesë vite pune. (Kjo pyetje duhet të përgjigjet nga persona fizikë që synojnë të marrin pjesë në kompaninë e sigurimeve që themelohet)

DEKLARATË

Unë _____ (emri i personit fizik)

a) Deklaroj / deklarojmë, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, që të dhënat e përfshira në këtë pyetësor, si dhe i gjithë dokumentacioni të cilin e dorëzoj në kuadër të kërkesës për dhënie të pëlqimit për pjesëmarrje të kualifikuar, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të rrejshme ose false.

b) Jam/jemi të njohur me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve që duhet t'i përmbushë për t'u bërë një aksionar me pjesëmarrje të kualifikuar.

c) Deklaroj/deklarojmë, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale, se do të siguroj respektimin e standardeve të mbikëqyrjes, do të zbatoj masat e marra nga Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe do t'i dorëzoj të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara nga Agjencia për të kryer mbikëqyrje efektive, duke siguruar kështu funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të kompanisë.

Vendi dhe data

Nënshkrimi i personit fizik

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJEN E SIGURIMEVE

KËRKESË¹

PËR DHËNIE TË PËLQIMIT PËR MARRJEN E TË DREJTËS PËR PJESËMARRJE TË KUALIFIKUAR NË SHOQËRI PËR PËRFAQËSIM NË SIGURIME, GJEGJËSISHT KOMPANI PËR BROKERIM NË SIGURIME

1.	Emri dhe mbiemri gjegjësisht titulli i personit që synon të marrë pjesë të kualifikuar	
2.	Numri dhe vlera nominale e aksioneve që një person tashmë posedon në kompani	
3.	Numri dhe vlera nominale e aksioneve që personi synon të marrë në shoqëri	
4.	Numri total dhe shuma nominale e aksioneve që personi do të ketë pas përvetësimit	
5.	Personi i autorizuar për kontakt me Agjencinë	
5.1.	Telefoni i personit të autorizuar	
5.2.	Adresa e postës elektronike e personit të autorizuar	
5.3.	Adresa e personit të autorizuar	

Kërkoj/kërkojmë nga Agjencia për Mbiqëqyrje të Sigurimeve që të na japë pëlqim për pjesëmarrje të kualifikuar në kompaninë për përfaqësim në sigurime gjegjësisht shoqërinë për brokerim në sigurime _____ (emri(titulli) i kompanisë).

Kërkesës i bashkangjes dokumentacionin sipas nenit 3 paragrafët (3) gjegjësisht (4) të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e fitimit të pjesëmarrjes së kualifikuar në kompani të sigurimit, kompani të brokerimit në sigurime dhe kompani për përfaqësim në sigurim ²si më poshtë vijon (secili dokument radhitet veçmas):.

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

¹ Rekomandohet që Kërkesa të plotësohet në mënyrë elektronike. Versioni elektronik i Kërkesës mund të gjendet në faqen zyrtare të Agjencisë për Mbiqëqyrjen e Sigurimeve . www.aso.mk. Nëse Kërkesa nuk plotësohet në mënyrë elektronike, domosdoshmërisht duhet të përdoret stilolaps dhe duhet të plotësohet me shkronja të mëdha.

²Dokumentacionin nga neni 3 paragrafi (3) pika 4) dhe 5), pika 6) nënpika 6.1, pika 7) nënpika 7.3, 7.5 dhe 7.6 pikat 12) dhe 13) dhe paragrafi (4) pika 4) dhe pika 7 nënpikat 7.3, 7.4, dhe 7.5 të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën për marrjen ose fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëri të sigurimit, shoqëri të brokerimit në sigurime dhe shoqëri ose kompani për përfaqësim në sigurime, Agjencia do ta marrë me detyrë zyrtare nga organi publik kompetent (nëse i njëjti dokumentacion nuk dorëzohet nga kërkuesi ose parashtruesi) për të cilën parashtruesi ose kërkuesi do të bëjë një deklaratë që autorizon Agjencinë në emër të tij/saj dhe në llogari të tij/saj t'i përdorë të dhënat që përmbahen në këtë Formular dhe në Agjenci dorëzohet dëshmi për pagesën e kryer në llogarinë e institucionit përgjegjës për lëshimin e dokumentit të duhur me shumën e përcaktuar nga tarifa e përcaktuar me ligj. Vërtetimin nga neni 3 paragrafi (4) pika (5) të këtij neni, Agjencia zyrtarisht do ta merr nga gjykata përkatëse kompetente (nëse i njëjti nuk paraqitet nga kërkuesi). Nëse personi është person i huaj, ai / ajo është i detyruar të sigurojë vetë informacionin e tillë nga autoritetet kompetente në vendin e huaj .

10. _____
11. _____
12. _____
13. _____

DEKLARATË E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Me parashtrimin e kësaj kërkesë, Deklaroj që të dhënat dhe informacionet në këtë kërkesë, si dhe i gjithë dokumentacioni që i bashkangjes kërkesës për dhënie e lejes për të kryer aktivitete sigurimi, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara dhe në rast të ndryshimit të të dhënave të përfshira në këtë kërkesë, si dhe të dokumenteve të bashknagjitura me këtë kërkesë, për një afat kohor prej 3 ditëve të punës prej ndodhjes së ndryshimit do ta njoftoj Agjencinë.

Me dorëzimin ose parashtrimin e kësaj kërkesë, unë jam dakord të përdoren të dhënat e mia personale të përfshira në këtë kërkesë në procedurën për realizimin e të drejtës time pranë organeve kompetente për të marrë dëshmi dhe të dhëna të nevojshme nga institucionet e tjera në mënyrë zyrtare dhe të njëjatat të përdoren në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Data dhe vendi i dorëzimit

_____. 20_____

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës³

³ Kërkesën e firmosin personat fizikë ose përfaqësuesit e autorizuar të personave juridikë që synojnë të fitojnë të drjetën për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri ose kompani për përfaqësim në sigurim gjegjësisht kompani për brokerim në sigurime.